



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 3658 Prot.
15

Patos, më 18/11 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 15 NËNTOR 2024

Vendi: "Salla e Këshillit Bashkiak Patos"

Ora e fillimit: 13:30

Ora e mbarimit: 15:30

Dëgjuesë publike me temë: "Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e Financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtore e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Urbanistikës znj. Boreta Murati, Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Gollosi, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, rreth 47 pjesëmarrës (të rinj të bashkisë Patos, anëtarë të KVR, përfaqësues të institucioneve arsimore etj).

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”.

Sot do të prezantojmë buxhetin përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-në 2025-2027. Po ja lë fjalën ekzekutivit për prezantimin e materialit të buxhetit.



**Sekretare e Këshillit
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Drejtoresha e Financave znj. Mimoza Shtembari- përshëndetje! Buxheti i vitit 2025 përbëhet nga të ardhurat kryesore, taksat dhe tarifatat dhe transfertat e pushtetit qendror. Për herë të parë peshën më të madhe të mbulimit të shpenzimeve dhe investimeve e zënë të ardhurat vendore. Gjithsej janë 17 programe ku përfshihet edhe programi i arsimit, sportit dhe rinisë.



**Drejtoresha e financës
Znj. Mimoza Shtembari**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Janë parashikuar edhe shpenzimet për të rinjtë për të cilat do ja lë fjalën drejtoreshës përkatëse.

Drejtoreshë e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj – përshëndetje!
Lidhur me buxhetin e 2025 unë do të filloj me arsimin bazë. Edhe pse ne jemi bashki e vogël ne kemi një strukturë të dedikuar për rininë dhe në kuafër të programit ReLOaD dhe në kuadër të aktiviteteve që kanë qenë të parashikuara nga projektet fituese të rinjtë janë bërë pjesë e shumë aktiviteteve të ndryshme me fokus te të rinjtë. Kur flitet për buxhetin për rininë koncepti është shumë i gjerë sepse edhe parashikimet e fondeve nga ana e bashkisë për



**Drejtoreshë e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

Dëgjësë publike me temë:

“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.

Nëntor 2024

mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, higjenën, ngrohjen e tj. Janë të dedikuara për këtë kategori. Për arsimin kemi parashikuar fond për ngrohje, mirëmbajtje, sigurinë publike ndaj emergjencave civile, kancelari etj. Gjithashtu kemi edhe fond të parashikuar për planin e rinisë dhe zbatimin e tij ku përfshihen bazë materiale dhe ekspertizë. Programi i shërbimeve kulturore ka të parashikuar fondet për të gjithë aktivitetet artistike kulturore.

Nxënëse në shkollën “Meleq Gostinishti”, Ermonela Muskaj- përshëndetje unë dëshiroj të prezantoj disa pyetje në emër të një anëtari të Këshillit Vendor Rinor, i cili nuk mund të ishte sot prezent, Veip Kamberaj. Pyetjet e adresuara mbi buxhetin për të rinjtë janë:



**Nxënëse në shkollën “Meleq Gostinishti”
znj. Ermonela Muskaj**

Dëgjësë publike me temë:

“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.

Nëntor 2024

- 1- Cilat janë prioritetet e bashkisë për përmirësimin e jetës së të rinjve në Patos? A do të ketë projekte specifike që synojnë të rinjtë ?
- 2- A ka plane për të inkurajuar punësimin e të rinjëve përmes nismave të veçanta?
- 3- A parashikohen në buxhet fonde për zhvillimin e programeve të trajnimit profesional dhe zhvillimit të aftësive për të rinjtë?
- 4- A janë planifikuar fonde për bursa për të rinjtë me rezultate të larta ose ata që ndodhen në nevojë ekonomike?
- 5- A parashikohet krijimi i një fondi të veçantë për të mbështetur iniciativat që propozojnë vetë të rinjtë për zhvillimin e komunitetit?
- 6- A ka parashikuar bashkia një fond të veçantë për të ndihmuar në krijimin dhe zhvillimin e biznesit për të rinjtë që duan të hapin Startup-e?
- 7- Çfarë masash do të merren për të financuar dhe përmirësuar zhvillimin e sportit dhe aktivitetet kulturore midis të rinjëve?
- 8- A do të financohet ndërtimi ose përmirësimi i qendrës rinore, bibliotekave dhe hapësirave për aktivitetet sociale dhe kulturore?

Drejtoresha e Integritetit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj- faleminderit Veipit për pyetjet që ka adresuar. Lidhur me përgjigjet dua të them që bashkia ka në



**Drejtoresha e Integritetit Europian, Arsimit dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

prioritetin e saj rivitalizimin e ambjentëve të brendshëm dhe dhënien e jetës së qendrës rinore. Ne synojmë që ajo godinë të marr trajtën dhe të ngrihet në nivel institucional. Është ofruar ndihmë dhe asistencë për të rinjtë lidhur me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme. Për punësimin e të rinjve nuk është funksion i drejtëpërdrejtë i njësive të vetqeverisjes vendore, por bashkia ofron bashkëpunimin e saj dhe lehtëson nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit ku të rinjtë vijnë dhe kryejnë praktikën profesionale. Nëpërmjet këtij programi ka patur edhe të rinj që kanë fituar vende pune në administratë pas përfundimit të praktikës. Bashkia parashikon edhe fonde për të rinjtë ekselentë dhe fituesit e

olimpiadës. Gjithashtu bashkia organizon edhe aktivitetet për Ditën e Rinisë ku ndahen edhe çmimet e ekselencës dhe certifikatat. Për pjeën e një fondi të dedikuar për rininë nuk kemi.

Drejtor i të ardhurave vendore z. Çajup Refitaj- për sa i përket pyetjes lidhur me bizneset e reja dhe që hapen nga të rinjtë ne kemi parashikuar në paketën e re fiskale disa lehtësira që



**Drejtor i të ardhurave vendore
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

lidhen me të diplomuarit dhe ata student që hapin biznes për herë të parë ku kemi menduar për përjashtimin nga taksat dhe tarifat. Edhe për emigrantët ne kemi parashikuar lehtësira fiskale.

Nxënës në shkollën “Zhani Ciko” Sokol Baxhia- unë kam një pyetje në fakt lidhur me qendrën rinore. Na është premtuar që deri në fund të dhjetorit ne do të mund të kemi një qendër rinore të konsoliduar dhe të mirëfilltë. Kur do të mundemi ne që të kemi një qendër të tillë. Gjithashtu kam edhe një problem tjetër që lidhet me internetin në shkollë. Ne nuk kemi



**Nxënës në shkollën “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

në internet funksional në shkollë dhe nuk mund të zhillojmë dot orët mësimore praktike në lëndën e informatikës.

Drejtores e ZVA Patos znj. Zamira Velçani- Lidhur me internetin në shkolla unë dua të shpjegoj që shkollat nuk kanë buxhet të mjaftueshëm që të mbulojnë edhe internetin. Megjithatë edhe unë si një përfaqësuese e institucionit arsimorë dëshiroj të bëj një pyetje ose të parashtroj një propozim. Bashkia ofron bursa për kategori të ndryshme nxënësish vulnerabël dhe ne kemi një numër të madh nxënësish, por çdo vit ngelet një numër i vogël që



**Drejtores e ZVA Patos
znj. Zamira Velçani**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

tërheq bursën. A ka mundësi bashkia që ta shikoj këtë kategori gjithmonë duke plotësuar dokumentacionin përkatës.

Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj- për sa i përket qendrës rinore unë e theksova që në fillim që kjo është një sfidë për vitin 2025 duke krijuar kushtet e mirëfillta në qendrën TregArt dhe duhet ngritur në nivel institucional. Lidhur me propozimin e ngritur nga Zamira dua të theksoj që ky është një fond që parashikohet nga



**Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit
dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Ministria dhe jo nga ne si institucion. Ne jemi në dy procese në trajtimin e bursave të arsimit profesional ku fondi trajtohet nga ministria e ekonomisë dhe jemi në procesin e bursave të arsimit të përgjithshëm. Listat me emrat e nxënësve mbrohen në Këshill pasi kanë aplikuar dhe fondi vjen nga institucioni qendror.

Drejtores e Financave znj. Mimoza Shtembari- për pjesën e menaxhimit të fondit dhe kompetencave ligjore janë kanalizuar përfitimet për të gjitha kategoritë që kanë nevojë dhe kemi VKM me fondin e parashikuar. Fondet që ne shërndajmë i kemi të ligjëruara me ligj.



Anëtare e Këshillit Vendor Rinor Enxhi Bregu- përshëndetje! Unë jam anëtarë e Këshillit Vendor Rinor dhe dua të paraqes një problem lidhur me mungesën e topave të volejbollit në shkollë gjatë orës së edukimit fizik.



**Anëtare e Këshillit Vendor Rinor
Enxhi Bregu**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Drejtores e ZVA Patos znj. Zamira Velçani- unë dua të sqaroj që pjesa e mjeteve didaktike në shkollë nuk mbulohen nga bashkia, por nga Ministria e Arsimit. Kjo është një pjesë e investimeve që nuk vjen nga bashkia pasi bashkia ka për detyrë të mbulojë pjesën e mirëmbajtjes së infrastrukturës.



**Drejtores e ZVA Patos
znj. Zamira Velçani**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi i buxhetit përfundimtar
për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Nxënës i shkollës “Zhani Ciko” Sokol Baxhia- kam një pyetje lidhur me himnin në shkollë që është vendosur si rregull dhe ne nuk kemi mjete për ta realizuar çdo ditë. Ne duhet të pajisemi me një foni në mënyrë që të na ndihmojë në realizimin e himnit çdo ditë. Gjithashtu ne kemi kërkuar edhe transport për të rinjtë me kohë të pjeshme.



**Nxënës i shkollës “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj- e kemi blerë foninë për shkollën që në muajin maj, por thjesht nuk është transferuar për të shkolla me



**Drejtores e Integritimit Europian, Arsimit
dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

inventarizim. Po punohet me inventaret e shkollave dhe do i kaloj shkollës tuaj në inventar.

Drejtoresha e shkollës “Sotir Çapo” znj. Matilda Kolici – përshëndetje! Unë e dëgjova me vëmendje prezantimin dhe doja të pyesja lidhur me masat dhe materialet që u përmendën që do të merren nëpër shkolla dhe parashikimet e bëra. A do të jenë këto parashikime që do të përfshijnë të gjitha shkollat apo vetëm brenda qytetit të Patosit?



**Drejtoresha e shkollës “Sotir Çapo”
Znj. Matilda Kolici**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Gjithashtu kam edhe një çështje për të ngitur lidhur me pjesën e aktiviteteve që organizohen për të rinjtë, pra për nxënësit tanë. A mund të parashikohet një fond posaçërisht për kostot e transportit të nxënësve në mënyrë që edhe nxënësit që janë nga fshatrat dhe janë larg të mund të frekuentojnë aktivitetet që zhvillon bashkia?

Drejtoresha e Integritit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj - Ne si bashki kemi ndihmuar edhe me pjesën e transportit të nxënësve në mënyrë që ata të marrin pjesë në aktivitete rinore dhe kemi mbuluar kostot e transportit duke lehtësuar edhe pjesëmarrjen e tyre. Gjithashtu edhe organizatat që kanë zhvilluar aktivitete në Patos në kuadër të projekteve të ndryshme kanë mbuluar kostot e transportit. Por që ne të blejmë një mjet dhe ta kemi vetëm në dispozicion për rininë kjo është pak e vështirë në këto kushte që jemi. Për sa i



**Drejtoresha e Integritit Europian, Arsimit
dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

përket fonisë ne nuk kemi parashikuar blerje në çdo shkollë, por nga ana e bashkisë nuk ka munguar bashkëpunimi dhe ne kemi ndihmuar me foninë tonë.

Anëtare e Këshillit Vendor Rinor Enxhi Bregu– Unë kam edhe një kërkesë tjetër përsa i përket bashkisë. Lidhur me pjesën e bibliotekës dhe infrastrukturës së saj. Do të kisha dëshirë që ne të kshim një bibliotekë me kushte të mira dhe salla leximi pasi biblioteka aktuale nuk është në kushte të mira dhe nuk na krijon kushtet e duhura për lexim.



**Anëtare e Këshillit Vendor Rinor
Enxhi Bregu**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Drejtoresha e financave znj. Mimoza Shtëmbari- Pallati i kulturës është një nga pallatet më të mëdha dhe ne jemi me fat që e kemi, por për restaurimin e tij është ndërtuar një projekt madhështor dhe shpresojmë shumë që ne të kemi mundësinë ta vendosim në jetë. Me restaurimin e pallatit të kulturës do të mund të rregullohet edhe pjesa e bibliotekës që është pjesë e tij.



**Drejtoresha e financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Mësuese e shkollës Ruzhdie znj. Ornela Shpërdheja- Ne kemi një problem serioz në fakt



**Mësuese e shkollës Ruzhdie
Znj. Ornela Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për
vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

sepse të gjithë po kërkojnë materiale didaktike, por ne na pikon çatia në shkollë dhe jemi në kushte shumë të vështira për zhvillimin e mësimin.

Drejtoresha e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve znj. Elda Goxhaj- unë jam njohur me problemin tuaj dhe ne kemi dërguar edhe më herët punonjës të agjencisë lidhur me



**Drejtoresha e Integritimit Europian, Arsimit dhe Sporteve
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

ndërhyrjet për këtë çështje. Kjo është vërtet një problem për zhvillimin e procesit mësimor dhe ne do të mundohemi që ta rregullojmë këtë problematik.

Sekretarja e Këshillit znj. Rafaela Xeba- Duke qenë se nuk ka pyetje të tjera mund ta konsiderojmë të mbyllur këtë dëgjese publike. Ju falenderojmë për pjesëmarrjen dhe shihemi në dëgjesa të tjera publike.



**Sekretarja e Këshillit
znj. Rafaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi i buxhetit përfundimtar për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027”.**

Nëntor 2024

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shaltina

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba





